



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 191/5 prot.

Tiranë, më 10.5.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 735, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 25.4.2024, është njoftuar vendimi nr. 735, datë 31.1.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 735, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Nushi, aktualisht ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

**2.1.** ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Dritan Nushi*”<sup>2</sup> ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**2.2.** DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit Raportin nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan \*\*\* Nushi*”. Pas kërkesës së Komisionit për përditësim, DSIK ka përcjellë të deklasifikuar plotësisht Raportin e kontrollit të figurës<sup>3</sup> për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Nushi.

**2.3.** KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin<sup>4</sup> për analizimin e aftësive profesionale të subjektit, z. Dritan Nushi.

**3.** Komisioni, shumica e trupit gjykues, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

**3.1. Për vlerësimin e pasurisë:** [...] *duke marrë në konsideratë rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur me të, krijimin e disa pasurive në periudhën para fillimit të detyrës dhe para lidhjes së martesës së subjektit, si dhe duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlerëson se: - Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka deklaruar saktësisht e plotësisht në këtë deklaratë pasuritë e tij, të personave të lidhur me të dhe të personave të tjerë të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës; Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara dhe nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht; Subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij [...].<sup>5</sup>*

**3.2. Për kontrollin e figurës:** [...] *Në përfundim... subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Nushi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].<sup>6</sup>*

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Shkresa e ILDKPKI me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.10.2018.

<sup>3</sup> Shkresa e DSIK-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2022. Deklasifikim plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2022, të KDZH-së.

<sup>4</sup> Raport i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.1.2023.

<sup>5</sup> Për më tepër referohuni në f. 32, të vendimit të Komisionit.

<sup>6</sup> Për më tepër referohuni në f. 67, të vendimit të Komisionit.

**3.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale:** [...] në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].<sup>7</sup>

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Nushi, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**5.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**6.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**7.** Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**8.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit.

**9.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 735/2024, të Komisionit, dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**10.** Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 735, datë 31.1.2024, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit.

## **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

### **III. A Lidhur me profesionalizmin dhe etikën**

#### **III. A/1. Vlerësimi i aftësive profesionale**

**11.** Komisioni, për vlerësimin e aftësive profesionale, është bazuar në këto burime të vlerësimit: (i) Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, miratuar nga KLP; (ii) Ankesat e paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme; (iii) Denoncimet e publikut.

**12.** Në aktin “Rezultatet e hetimit administrativ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për disa çështje, të cilat do të gjejnë trajtim në vijim.

<sup>7</sup> Për më tepër referohuni në f. 67, të vendimit të Komisionit.

**13. Vendim i pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2015,<sup>8</sup> i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në ngarkim të shtetasit meksikan \*\*\* \*\***

**13.1.** Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton sa vijon:

**13.1.1.** Subjekti i rivlerësimit është prokurori i çështjes në hetimin e procedimit penal me nr. \*\*\*, viti 2015, regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit meksikan \*\*\* \*\*\*, arrestuar në Komisaratin e Policisë për Kufirin dhe Migracionin, Aeroporti “Nënë Tereza”. Me vendimin e datës \*.5.2018, subjekti, z. Nushi, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit meksikan, z. \*\*\*. \*\*\*. \*\*\*.

**13.1.2.** Rezulton se, më datë \*.3.2015, është arrestuar në flagrancë shtetasi meksikan \*\*\* \*\*\*, i datëlindjes \*.7.1984, lindur dhe banues në \*\*\* \*\*\*, Meksikë, i cili është kthyer nga autoritetet policore turke në aeroportin e Stambollit, si person i kategorisë “INAD”, pasi dyshohej se pasaporta e tij meksikane ishte e falsifikuar. Shtetasi nuk ka pranuar që pasaporta e tij të ishte e falsifikuar, pasi e kishte nxjerrë nëpërmjet Konsullatës Meksikane në Los Angelos, SHBA.

**13.1.3.** Drejtoria e Policisë Shkencore, me Aktin me nr. \*\*\*, datë \*.3.2015 (Ekspertim teknik pasaporte) ka arritur në përfundimin se: (i) te pasaporta meksikane, me nr. \*\*\*, në emër të shtetasit \*\*\* \*\*\*, objekt ekspertimi, konstatohen ndërhyrje falsifikuese; (ii) falsifikimi konsiston në riprodhimin e modularit të faqes së të dhënave me anën e makinave fotokopjuese me ngjyra (përfshi skanerin), me plotësimin e të dhënave aktuale dhe ngjitjen në faqen nr.1 të pasaportës.

**13.1.4.** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit<sup>9</sup> i dërgon Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë informacion dhe dokumentacion të përcjellë pranë saj nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore<sup>10</sup> dhe Diasporës në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Nga përmbajta e kësaj shkrese rezulton se informacioni dhe hollësitë për dokumentin *pasaportë* janë përcjellë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme nga Konsulli i Përgjithshëm i Nderit i Shteteve të Bashkuara të Meksikës në Shqipëri dhe përmban si vijon: (i) Shkresë e datës \*.4.2015, pa referencë numër protokoll, e nënshkruar nga Konsulli i Përgjithshëm i Nderit, z. \*\*\* \*\*\*, me timbër “Consulado Honorario de Mexico Tirana Albania” (ii) *Email* me dokumentacion, me dërgues [adresën \\*\\*\\*@\\*\\*.\\*.\\*\\*\\*](mailto:***@**.*.***), në gjuhën spanjolle së bashku me dokumentacion shoqërues të përkthyer në gjuhën shqipe.

**13.1.5.** Më datë \*.5.2015, subjekti, bazuar në nenin 328/1, germa “a” të K. Pr. Penale, ka vendosur “Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015”, në ngarkim të shtetasit \*\*\* \*\*\*, pasi del qartë se fakti nuk ekziston, ku ndër të tjera arsyeton si vijon: [...] *Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë është depozituar praktika nr. \*\*\* prot., nëpërmjet së cilës përcillet dokumentacioni dhe dokumente në lidhje me ndalimin e shtetasit meksikan \*\*\* \*\*\*, në datën \*.3.2015, në Aeroportin Rinas; kopje e informacionit të dërguar nga Konsulli i Përgjithshëm i Nderit i Shteteve të Bashkuara të Meksikës në Shqipëri, \*\*\* \*\*\*, dokumente të njësuara me origjinalin, që shtetasi \*\*\* ka dorëzuar në momentin që ka aplikuar për pasaportën që ka aktualisht etj. Ndër këto dokumente, subjekti vlerëson si me shumë rëndësi për hetimin, një formular aplikimi për pasaportë të zakonshme me fotografi dhe gjurmë daktiloskopike të dy gishtave të dy duarve, i cili është plotësuar në Konsullatën e Meksikës në San Bernardino CA, me gjeneralitetet e \*\*\*. \*\*\*. \*\*\*, si ato në pasaportë, si dhe foto me ngjyra që është e po të njëjtit person, e njëjtë me foton që gjendet edhe në pasaportën*

<sup>8</sup> Një nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>9</sup> Shkresa me nr. \*\*\*/\*\*/ prot., datë \*.5.2015, e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda (në faqen e parë ka një vulë datare protokoll me nr. \*\*\*, datë \*.5.2015).

<sup>10</sup> Shkresa me nr. prot. \*\*\*, indeksi \*/\*\* \*\*\*, \*\*\*, datë \*.4.2015, gjithsej 19 fletë.

e sequestruar; ...nga dokumentacioni i ardhur rishtaz, megjithëse jo në rrugën e duhur procedurale, provohet se të dhënat që gjenden në pasaportën meksikane të shtetasit \*\*\* \*\*\*, objekt ekspertimi, bashkë me fotografinë e këtij shtetasi, janë të njëjta me ato të dërguara nga autoritetet meksikane, nëpërmjet praktikës së Drejtorisë së Policisë së Shtetit [...].

**13.2.** Komisioni, në aktin “Rezultatet e hetimit...”,<sup>11</sup> lidhur me këtë çështje, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në konsideratë kryerjen e një akti ekspertimi, si një provë e rëndësishme në vepra penale të këtij lloji “Falsifikimit të letërnjoftimeve, i pasaportave, vizave”, me qëllim marrjen e një vendimi të bazuar në prova dhe ligj.

**13.3.** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se: [...] Pas interesimit tonë edhe në rrugë diplomatike, më datë \*\*.05.2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, ka mbërritur praktika nr. \*\*\* prot., ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga e cila njoftohemi se Drejtoria e Çështjeve Konsullore dhe Diasporës në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, i ka përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, informacionin dhe dokumentet në origjinal spanjisht dhe të përkthyer edhe në shqip, në lidhje me ndalimin e shtetasit meksikan \*\*\* \*\*\*, më datë \*\*.03.2015, në Aeroportin e Rinasit, konkretisht shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*.04.2015 e kësaj Drejtorie, kopje e informacionit të dërguar nga Konsulli i Përgjithshëm i Nderit i Shteteve të Bashkuara të Meksikës në Shqipëri, datë \*\*.04.2015, i cili, thjesht, ka përcjellë materialet dhe informacionin që i ka ardhur nga Ambasada e Meksikës në Romë, ...dokumente<sup>12</sup> të njësuara me origjinalin dhe që shtetasi \*\*\* ka dorëzuar në momentin që ka aplikuar për pasaportën që ka aktualisht etj.

Nënshkrimi i hedhur nga \*\*\*, në aktet procedurale të marrjes në pyetje nga Policia shqiptare, dhe me sy të lirë, dallohet që është i njëjtë në të gjitha rastet, me nënshkrimin që ndodhet në aktet e dërguara nga Ambasada Meksikane në Romë, në aplikimin që ka ai ka bërë për pajisje me pasaportë në Konsullatën e Meksikës në San Bernardinos SHBA, konkretisht në dokumentet: - formular aplikimi për paisje me pasaportë ..., dhe - format i kontrollit të të dhënave në regjistër (Konsullata e Meksikës në San Bernardino SHBA), si dhe me nënshkrimin, në pasaportën e sequestruar. Nga gjithë këto prova dhe fakte, provohej se të dhënat që gjendeshin në pasaportën meksikane të sequestruar, objekt ekspertimi me nr. \*\*\*, në emër të shtetasit \*\*\* \*\*\*, bashkë me fotografinë e këtij shtetasi, ishin të njëjta me gjithë të dhënat dhe fotografitë e dërguara nga autoritetet meksikane tek ne, nëpërmjet praktikës së ardhur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të kontrolluara edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Provohej se kjo pasaportë ishte lëshuar nga një autoritet kompetent i huaj konsullor, jashtë territorit të shtetit amë, Meksikës. Provohej nga dokumentacioni i ardhur zyrtarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme, se shtetasi \*\*\*, që është kapur si mbajtës i kësaj pasaporte, në vitin 2015, ka qenë pikërisht ai që kishte aplikuar për t’u paisur me të, në San Bernardino Kaliforni, SHBA, si dhe që e ka përfutur atë në rrugë ligjore. Me këtë pasaportë është provuar, nëpërmjet vulave që kishte, se \*\*\* kishte udhëtuar nëpër disa vende të botës, pa problem. Deklarimet dhe alibitë e tij përputhen me provat e administruara. Gjithashtu, por më kryesorja, shtetësi \*\*\* \*\*\*, me ato gjeneralitete, foto apo gjurmë daktiloskopike të dhëna dhe të krahasuara në sistem, nuk rezultonte deri në momentin e marrjes së vendimit nga ana ime, i skeduar apo i dyshuar për ndonjë aktivitet kriminal apo kryerjen e ndonjë vepre penale, brenda apo jashtë territorit të shtetit shqiptar. E vetmja provë kundër të gjithë këtyre, është një akt ekspertimi teknik, i bërë nga një ekspert i Policisë Shkencore që, për më tepër, ka bërë një akt

<sup>11</sup> Referohuni f. 28 të aktit “Rezultate të hetimit...”.

<sup>12</sup> Ndër këto dokumente janë: (i) kopje të formularit me fotografi, të plotësuar dhe nënshkruar nga z. \*\*\*, në Konsullatën e San Bernardino KA, për t’u pajisur me pasaportë 3-vjeçare, më datë \*\*.5.2014; (ii) certifikatë lindjeje e shtetasit \*\*\*, sipas regjistrimit të Gjendjes Civile të Shteteve të Bashkuara të Meksikës; (iii) kartë matrikulli konsullor me fotografi, me afat 4-vjeçar, lëshuar po nga Konsullata Meksikane në San Bernardino KA; (iv) kuponi tatimor; paguar prej 74 USD në Konsullatë në San Bernardino, për pajisjen me pasaportën në fjalë, më datë \*\*.5.2014 etj.

*ekspertimi teknik dokumenti në atë kohë, bazuar vetëm nga pamja vizuale e dokumentit dhe pa e krahasuar atë, detyrimisht, me specimenin e këtyre dokumenteve, që ruhen në arkivin e institucionit ku ai punonte, me arsyen e thjeshtë që më është thënë në atë kohë verbalisht, se ky institucion në atë kohë pra IPSH-ja, nuk dispononte një specimen të tillë, pra të shtetit të Meksikës [...]*<sup>13</sup>.

**13.4.** Komisioni arriti në përfundimin se në veprimet e subjektit nuk rezultuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi në lidhje me kriterin profesional, duke arsyetuar si vijon: [...] se në lidhje me analizën e elementeve të veprës penale që bën subjekti në prapësimet e tij, kjo i përket anës materiale të çështjes dhe, për këtë, Komisioni nuk ka kompetencë shqyrtimi dhe vlerësimi, referuar nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016; Nga ana procedurale, Komisioni vlerëson se subjekti e ka çmuar aktin e ekspertimit në raport dhe në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, duke respektuar nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale, “Çmuarja e provave”, për të arritur në konkluzionin nëse ka apo jo elemente të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”; Sa më lart vlerësohet se subjekti ka dhënë argumente të mjaftueshme bindëse bazuar edhe në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë se për procedimin në fjalë nuk është bërë e mundur të provohet plotësisht tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, me të gjitha elementet e saj dhe, si rrjedhojë, çdo dyshim shkon në favor të pozitës së të akuzuarit. Për këtë arsye, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal [...].<sup>14</sup>

**13.5.** Komisioneri Publik, referuar këtyre të dhënave, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vëren të meta në veprimet procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e procedimit penal me nr. \*\*\*, viti 2015, konkretisht:

**13.5.1.** Riti procedural i parashikuar nga legjislacioni penal për marrjen e provave nga autoritete e huaja është ai i përcaktuar në Seksionin II, “Letërporositë për jashtë shtetit”, nenet 509 dhe 511 të Kodit të Procedurës Penale, e cila rezulton se nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit. Rrugë të tjera procedurale dhe aplikimi i të tjera rrugëve jozyrtare, i bën ato të marra jo nga burimet e parashikuara në ligjin procedural penal dhe në përputhje me rregullat e caktuara prej tij, si rrjedhojë të papërdorshme.

**13.5.2.** Edhe në këndvështrim të rregullave të tjera ligjore procedurale, shkresat në gjuhën e huaj duhet të paraqiten me përkthimin në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent. Aktet e administruara në dosje të këtij procedimi penal, të marra nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk janë marrë në rrugën e duhur procedurale, fakt i cili është pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit për pushimin e çështjes, datë \*\*.5.2015.

**13.5.3.** Gjithashtu është me vend të theksohet edhe rrethana tjetër në hetimin e këtij procedimi penal, të cilit nuk i është kushtuar vëmendje, që lidhet me marrëdhëniet juridiksionale me një shtet të tretë, siç është Turqia, autoritetet ligjzbatuese të së cilës e kanë kthyer shtetasin meksikan \*\*\* \*\*\*, pasi e kanë kategorizuar si person i kategorisë “INAD”, duke qenë se dyshohej se pasaporta e tij meksikane ishte e falsifikuar.

**13.5.4.** Për sa i përket aktit të ekspertimit teknik të pasaportës, nr. \*\*\* datë \*\*.3.2015, i Drejtorisë së Policisë Shkencore, me objekt pasaportën meksikane me nr. \*\*\*, të shtetasit \*\*\* \*\*\*, nuk është bazuar vetëm nga pamja vizuale e dokumentit, siç ka pretenduar subjekti në prapësimet e tij para Komisionit, por dokumenti objekt ekspertimi është ekzaminuar me mjete shkencore të përshtatshme, siç janë lente me shkallë të ndryshme zmadhimi, mikroskop

<sup>13</sup> Referohuni f. 29-30 të versionit elektronik të aktit “Prapësime në lidhje me rezultatet e hetimit...”

<sup>14</sup> Referohuni në pikat 17, 18, 19, f. 37 e vendimit.

sterioskopik binokular, me dritë të përqendruar, me fibra optike “Euromex”, dhe aparatën video-spektral krahasues të kompjuterizuar VSC 2000.

**13.6. Komisioneri Publik**, për sa më lart, vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e çmuarjes drejt të provës, aktit të ekspertit teknik nr. \*\*\* datë \*\*.3.2015, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**14. Denoncim i shtetas** \*\*\* \*\*\*<sup>15</sup> (\*\*\*), e cila ankohet për vendimin e subjektit të rivlerësimit, për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2013, pa asnjë vlerësim.

**14.1. Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton sa vijon:**

**14.1.1.** Subjekti i rivlerësimit është prokurori i çështjes në hetimin e procedimit penal me nr. \*\*\*, të vitit 2013, regjistruar për veprën penale “Ekspertim i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, pa autor, mbi bazën e materialeve kallëzuese të referuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë. Me vendimin e datës \*\*.3.2014, subjekti, z. Nushi, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2013.

**14.1.2.** Znj. \*\*\* është palë në disa procese gjyqësore civile të zvarritura e të pushuara ndër vite, për një pasuri të paluajtshme në qytetin e Tiranës, ku pretendon se është vjedhur nga nipërit, në bashkëpunim me noteren \*\*\* \*\*\*, duke falsifikuar disa akte. Bashkëshorti i denoncueses, në kallëzimin penal të datës \*\*.6.2013, ka kërkuar ndjekjen penale për ekspertin \*\*\* \*\*\*, i cili, në procesin civil, ka bërë akt-ekspertim të njëanshëm, datë \*\*.11.2012, të kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.1990 (në të cilën pasqyrohej fakti se \*\*\* dhe motrat e saj i dhuronin \*\*\* \*\*\* të gjithë pasurinë që rridhte nga trashëgimia e \*\*\* \*\*\*, duke hequr dorë vullnetarisht secila nga pjesa trashëguese të kësaj pasurie, si dhe për noteren \*\*\* \*\*\*, për falsifikimin e kësaj kontrate dhe të dëshmisë së trashëgimisë nr.\*\*\*, datë \*\*.4.1990, ku denoncuesja nuk figuron si trashëgimtare e nënës së saj.

**14.1.3.** Mbi bazën e kallëzimit penal, datë \*\*.6.2013, të shtetasit \*\*\* \*\*\* (bashkëshorti i denoncueses), referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, të vitit 2013, për veprën penale “Ekspertimi i rremë” pa autor, nga një tjetër prokuror. Me vendimin datë \*\*.12.2013, të drejtuesit të Prokurorisë, është zëvendësuar prokurori i çështjes, duke caktuar subjektin e rivlerësimit, z. Nushi. Me kallëzimin datë \*\*.1.2014, bashkëlidhur denoncimit, denoncuesja ka bërë shtesë të kallëzimit të parë, duke kërkuar ndjekje penale ndaj noteres \*\*\* \*\*\* për falsifikimin e aktit noterial nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.1990, dhe dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, datë \*\*.4.1990, ku denoncuesja nuk figuron si trashëgimtare e nënës së saj. Nga aktet në dosje, ky kallëzim shtesë që denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit pranë Komisionit, nuk figuron i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe nuk është pjesë e fashikullit të dosjes penale që ka administruar Komisioni.

**14.1.4.** Rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë është ngritur padi nga denoncuesja \*\*\* \*\*\*, e cila, midis të tjerash, ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.1990. Në vitin 1986, me dëshmi trashëgimie, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka njohur znj. \*\*\* \*\*\* (\*\*\*) si trashëgimtare të babait të saj, duke përfituar ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore. Në vitin 2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka njohur si trashëgimtare të nënës së saj, duke përfituar 1/3 pjesë të pasurisë së saj, ndërkohë që në aktin e dhurimit, datë \*\*.9.1990, firmat e palëve nënshkruese nuk janë konfirmuar me pasaporta apo dokumente identifikimi. Gjatë gjykimit, me akt-ekspertimin nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2012, eksperti \*\*\* \*\*\* ka konkluduar se nënshkrimi për shtetasen \*\*\* \*\*\*, në kontratën e dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.1990, është shkruar prej saj. Padi të sjaja nuk ka qenë dakord me këtë akt ekspertimi dhe ka kërkuar riekspertim, madje ka kryer

<sup>15</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.3.2018.

privatisht një akt ekspertimi nga dy ekspertë kriminalistë, të cilët kanë konkluduar se nënshkrimet në kontratën e dhurimit nuk janë të shtetasë \*\*\* \*\*\*, por gjyqtarja ia ka refuzuar kërkesën për të administruar këtë akt-ekspertim.

**14.1.5.** Përveç veprimeve hetimore të kryera nga oficerët e Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, janë kryer veprime hetimore edhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si marrja në pyetje e ekspertit \*\*\* \*\*\*, dhe bashkëshortëve \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*<sup>16</sup>, administrimi i akteve nga dosja e çështjes civile e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.2.2014, gjyqtarja që gjykonte çështjen civile me objekt pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.9.1990, njofton Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë se çështja është në proces gjykimi.

**14.1.6.** Me vendimin datë \*\*.3.2014, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013, në bazë të nenit 328/1, shkronja “F”<sup>17</sup> e Kodit të Procedurës Penale. Në dispozitivin e vendimit, subjekti citon: [...] *Gjykata (civile - shënimi ynë) është ende në hetim dhe shqyrtim gjyqësor të çështjes ku, ndër të tjera, është objekt kryesor ekspertimi për falsitetin e dokumentit të sipërcituar kontratë dhurimi... pra cikli gjyqësor është i pambyllur [...].* Gjithashtu, subjekti si bazë ligjore ka referuar edhe nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me falsitetin.

**14.2.** Komisioni në aktin “Rezultatet e hetimit..”,<sup>18</sup> lidhur me këtë çështje i ka kaluar subjektit barrën e provës të provojë të kundërtën, pasi duket se subjekti i rivlerësimit ka pushuar procedimin penal “Ekspertim i rremë”, në ngarkim të ekspertit \*\*\* \*\*\*, në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka kryer hetime të plota për të konkluduar nëse ka vepër penale nga ana e noteres \*\*\* \*\*\*.

**14.3.** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se: [...] *Duke qenë se palët janë në konflikt civil para gjyqësorit, sipas ligjit, është Gjykata Civile dhe vetëm ajo organi kompetent që, në analizë të neneve 272, 273, 274 dhe 275 të K. Pr. Civile. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështje civile konstatohet se ka dyshime për falsitetin e një dokumenti të paraqitur para saj dhe ajo provë vlerësohet thelbësore për sqarimin e çështjes, pezullon gjykimin deri në përfundimin e çështjes penale. Pala që pretendon falsitetin e një dokumenti është e detyruar të paraqesë prova para Gjykatës, në rast të kundërt, është i papranueshëm për Gjykatën. Sipas nenit 275 të po këtij Kodi, Sekretaria e Gjykatës dërgon menjëherë kopjen e çdo vendimi që shpall shkresën si të falsifikuar në Prokurorinë kompetente dhe në organin që ka nxjerrë shkresën... Me këto dispozita sanksionohet se, nëse në një proces gjyqësor civil, paraqitet nga palët një provë dokumentare që dyshohet e falsifikuar, me kërkesën e palës që pretendon falsitetin, ose ndërpritet shqyrtimi gjyqësor civil i çështjes, dhe dërgohet për hetim në Prokurorinë kompetente, ose Gjykata shqyrton falsitetin ose jo të dokumentit dhe nëse e gjen fallco, deklaron këtë fakt në vendimin e saj përfundimtar, duke pasur detyrimin të njoftojë Prokurorinë për këtë fakt... Për rastin konkret, ka qenë vetë Gjykata civile që ka shqyrtuar pretendimin për falsitet, pa e ndërprerë shqyrtimin gjyqësor të çështjes, me ekspertë të Policisë Shkencore Shtetërore (të njëjtët do të merrshin edhe nga ne, për t'i dhënë zgjidhje një problemi të tillë), dhe i ka dhënë vetë zgjidhje, pa iu drejtuar organit të Prokurorisë. Kjo provohet edhe me faktin se, në atë kohë, pranë kësaj Prokurorie, nuk është regjistruar asnjë njoftim nga Gjykata, ashtu siç e parashikon neni 275 i K. Pr. Civile.*

*Për sa i përket hetimit të ndjekur nga ana jonë, lidhur me urdhërimet e këtij neni, deri në kohën e vendimmarrjes tonë, Gjykata civile po investojë seriozisht për zgjidhjen e çështjes në fjalë, nuk kishte një vendim civil të formës së prerë dhe nuk ndodheshim në kushtet e pezullimit... Për sa kohë shkencërisht, me akt ekspertimi, vendim gjykate dhe me prova të tjera, nuk më rezultonte ndonjë dokument i falsifikuar në atë kohë, rrjedhimisht që nuk kishte vend për të*

<sup>16</sup> Respektivisht në datat \*\*.7.2013 dhe \*\*.9.2013.

<sup>17</sup> Germa “F” përcakton “në rastet e tjera të parashikuara me ligj”.

<sup>18</sup> Referohuni f.43 të aktit “Rezultate të hetimit...”.



hetuar në lidhje me pretendimet që ju thoni për noteren \*\*\*, që rezultonte se e kishte hartuar dokumentin në vitin 1990, pasi vepra penale e falsifikimit të dokumenteve e pretenduar, nëse ekzistonte, sipas nenit 186/3 të K. Penal, kishte një sanksion dënimi nga një deri në shtatë vjet burgim, por në vitin 2014, rezultoi e parashkruar ndjekja penale, konform nenit 66, germa "c" të K. Penal. Për sa i përket shtesës së kallëzimit, të pretenduar nga kallëzuesja së është bërë prej saj, për sa kohë që nuk gjendet në dosje, deklaroj se nuk është paraqitur para meje gjatë kohës që çështja ishte në hetim... Për më tepër, me këtë vendimmarrje timen, kallëzuesja ka qenë dakord dhe nuk e ka ankimuar [...].<sup>19</sup>

**14.4.** Komisioni arriti në përfundimin se: [...] Në kushtet kur Gjykata Civile nuk kishte marrë vendim për të administruar provat e paraqitura në gjykim, përfshirë këtu edhe aktet e ekspertimeve, për të cilat ende nuk kishte dhënë një vlerësim, subjekti nuk mund të hetonte për aktin e ekspertimit dhe kontratën e dhurimit, për vlefshmërinë e të cilave nuk ishte shprehur ende kjo Gjykatë. Për sa më lart, nën dritën e neneve 272, 273, 274 e 275 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 70 e 71 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni arrin në përfundimin se nuk rezultoi të ketë mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, që mund ta ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional [...].<sup>20</sup>

**14.5.** Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Komisioni, duke mbajtur në konsideratë dhe rëndësinë e arsytimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor<sup>21</sup>, vlerëson se arsytimi i dhënë në këtë rast nga subjekti i rivlerësimit, duket se është në kushtet e mungesës së një argumentimi ligjor, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013, nuk janë bindëse, pasi:

**14.5.1.** Shkaku që përdor subjekti në vendimin e pushimit të procedimit, se nuk është mbyllur gjykimi civil me objekt goditje të kontratës për falsitet, nuk gjen referencë ligjore. Subjekti i rivlerësimit duket se në mënyrë të gabuar vlerëson kompetencën e Prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale krahasuar me kompetencën e Gjykatës Civile, pasi Gjykata gjykon për pavlefshmëri kontrate për shkak falsifikimi, i cili do të provohej nëpërmjet aktit të ekspertimit, ndërsa organi i akuzës duhej të hetonte për faktin nëse ky akt-ekspertimi është apo jo i rremë dhe këtë hetim nuk mund ta kryejë Gjykata në një proces civil, por vetëm organi i akuzës. Pra, në rastin konkret, hetimet penale nuk vareshin nga gjykimi civil.

**14.5.2.** Edhe sikur hetimi penal të varej nga gjykimi civil, nisur nga fakti që në kallëzim dhe në shtesën e kallëzimit, është kërkuar ndjekja penale ndaj noteres \*\*\*, edhe për falsifikimin e dëshmisë së trashëgimisë nr.\*\*\*, datë \*\*.4.1990, që nuk ka qenë objekt i ekspertizës së ekspertit \*\*\*, atëherë subjekti i rivlerësimit nuk kishte pse të kushtëzonte kryerjen e hetimit penal për të provuar falsifikimin e dëshmisë së trashëgimisë, e cila nuk po gjykohej për falsitet në procesin civil.

**14.5.3.** Vërejmë se subjekti i rivlerësimit, z. Nushi, duket se ka kanalizuar të dhënat e kallëzimit drejt konfliktit civil, dhe nuk ka konsideruar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale, edhe pse në rastin konkret *proceset gjyqësore të zhvilluara pranë gjykatave civile nuk kanë pasur objekt padie "goditjen e akteve për falsitet"*, duke mos i dhënë zgjidhje konfliktit të palëve, që duket se vazhdon me të njëjtat rrethana dhe shumë kohë pas vendimit të mosfillimit të subjektit.

**14.5.4.** Rregullimet procedurale në legjislacionin penal dhe atij civil përcaktojnë qartë juridiksionet (neni 69 i K. Pr. Penale dhe neni 36 i K. Pr. Civile), të cilat nuk kanë raport

<sup>19</sup> Referohuni f. 60-66 të versionit elektronik të aktit "Prapësime në lidhje me rezultatet e hetimit...".

<sup>20</sup> Referohuni f. 55 të vendimit.

<sup>21</sup> Shihni vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

ndërvarësie me njëra-tjetrën, po ushtrohen nga gjykatat respektive në mënyrë të pavarur, duke parashikuar *komplementaritetin* në funksion të dhënies së drejtësisë përmes dispozitave të neneve 70 e 71 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 270, 271, 272, të Kodit të Procedurës Civile.

**14.5.5.** Gjithashtu rezulton se qëndrimi përfundimtar i Komisionit në këtë rast është i ndryshëm dhe bie ndesh me arsyetimin po në këtë vendim të Komisionit, për denoncimin e shtetasit \*\*\*<sup>22</sup>, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku ka parashtruar se juridiksioni penal dhe ai civil mund të zhvillohen paralelisht, duke arsyetuar se: [...] në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2019, me të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e subjektit, argumentohet se Prokuroria ka gabuar në vendimin e saj, kur citon që kallëzimin duhet ta bënte Gjykata Civile, pasi në rastin konkret proceset gjyqësore të zhvilluara pranë gjykatave civile nuk kanë pasur objekt padie “goditjen e akteve për falsitet”. Si rrjedhojë, gjykata nuk mund të bënte kallëzim, pasi të konstatonte faktin penal të akteve të falsifikuara. Gjykata vetëm i ka administruar këto akte si prova në gjykim. Juridiksioni penal dhe ai civil mund të zhvillohen paralelisht dhe vendimi penal mund të përdoret më pas në procesin civil [...].<sup>23</sup>

**14.6.** Në përfundim, lidhur me këtë procedim penal, vlerësojmë se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në pushimin e procedimit penal, duke e lidhur atë me juridiksionin civil, tregon për mangësi sipas përcaktimit të nenit 73, “Aftësia profesionale e prokurorit”, pika 2 e tij aspekti për të ndërmarrë logjikisht hetimin, dhe duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të tria kriterëve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**15. Denoncim i shtetases** \*\*\*<sup>24</sup>, e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit, pasi ka anashkaluar provat dhe nuk ka hetuar dokumentet që i ka vënë në dispozicion dhe ato që ka marrë vetë kryesisht; e ka zvarritur hetimin për 7 muaj, pa vendime të shtyrjes së afateve hetimore, ka vendosur pushimin e çështjes, si dhe nuk i është përgjigjur kërkesave të kallëzuesit, për informacion mbi zhvillimin e hetimeve.

**15.1.** Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit rezulton sa vijon:

**15.1.1.** Subjekti i rivlerësimit është prokurori i çështjes në hetimin e procedimit penal me nr. \*\*\*, regjistruar më datë \*\*.3.2018, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, pa autor, me kallëzues shtetasin e dëmtuar \*\*\*. Me vendimin e datës \*\*.10.2018, subjekti në cilësinë e prokurorit, në përfundim të hetimeve paraprake i është drejtuar gjyqtarit për hetime paraprake në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë, me kërkesën për pushimin e çështjes penale me nr. \*\*\*.

**15.1.2.** Gjykata, me vendimin e datës \*\*.12.2018, ka vendosur kthimin e akteve të hetimeve paraprake për t’i vazhduar ato, duke i lënë një afat 60 ditë nga dita që vendimi merr formë të prerë. Gjykata ka konstatuar se konkluzionet e organit të Prokurorisë janë të nxituara dhe rezultat i veprimeve jo të plota hetimore, duke i lënë këto detyra organit të akuzës: (i) të ribëhet ekspertimi autoteknik me tre ekspertë; (ii) të verifikohet nëse është kryer apo jo testi me alkoolmatës ndaj drejtuesit të mjetit të përfshirë në aksidentin automobilistik, shtetasit \*\*\*.\*\*\*.; (iii) të ripyetet kallëzuesi për faktin nëse disponohen prova që i shërbejnë këtij hetimi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.2.2019, pasi është ankimuar nga ana e organit të Prokurorisë.

**15.2.** Komisioni, në aktin<sup>25</sup> “Rezultatet e hetimit administrativ...”, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se subjekti: (i) ka zvarritur hetimet dhe nuk ka kryer hetime të plota, prandaj Gjykata i ka kthyer aktet për hetime të mëtejshme; (ii) ka cenuar të

<sup>22</sup> Regjistruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2019.

<sup>23</sup> Referohuni f. 58 të vendimit.

<sup>24</sup> Regjistruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.3.2019.

<sup>25</sup> Referohuni f. 71-77 të aktit.

drejtën e personit të dëmtuar nga vepra penale, që të njihet me hetimin dhe materialet hetimore dhe nuk i është përgjigjur kërkesave dhe memove të tij, të drejta këto që parashikohen nga neni 58, pikat 1/d, 1/dh, neni 105, neni 110, neni 279/a të K. Pr. Penale.

**15.3.** Subjekti i rivlerësimit i përgjigjet barrës së provës në aktin “Prapësime...”<sup>26</sup>.

**15.4.** Komisioni ka arritur në përfundimin si vijon: [...] *Denoncuesja ka pretenduar se subjekti ka zvarritur hetimet për 7 muaj, pa disponuar me vendime për shtyrje të afatit. Komisioni sjell në vëmendje se, sipas parashikimeve të neneve 323 dhe 324, të Kodit të Procedurës Penale, brenda afatit të përgjithshëm 2-vjeçar, hetimet zgjasin deri 3 muaj nga data kur regjistrohet emri i personit që i atribuohet vepra penale e, më pas, zgjatja e afatit të përfundimit të hetimeve bëhet çdo tre muaj. Në rastin e procedimit penal të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton që procedimi penal është regjistruar pa emër të autorit të veprës penale, kështu që subjekti nuk mund të dispononte me vendime për shtyrje të afatit të hetimeve<sup>27</sup>; Nga ana tjetër, në lidhje me konstatimin se subjekti nuk u është përgjigjur kërkesave procedurale dhe memove të kallëzuesit, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka cenuar të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale, që të njihet me hetimin dhe materialet hetimore dhe nuk u është përgjigjur kërkesave dhe memove të tij, të drejta këto që parashikohen nga neni 58, pikat 1/d e 1/dh dhe nenet 105, 110 e 279/a të Kodit të Procedurës Penale, por, parë kjo nën dritën e një vlerësimi proporcional dhe objektiv, që ka të bëjë me këtë procedim në tërësi, veprimet hetimore procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, vendimmarrjet e tij dhe ato të gjykatës, si dhe nisur nga fakti që vendimi përfundimtar i pushimit i marrë nga subjekti i rivlerësimit ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga ana e kallëzuesit, Komisioni arrin në përfundimin se kjo problematikë nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin profesional [...]*<sup>28</sup>.

**15.5.** Komisioneri Publik, ndërsa mban qëndrim të njëjtë lidhur me përfundimin e arritur nga Komisioni, se subjekti ka cenuar të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale, ndan qëndrim të ndryshëm lidhur me afatet e hetimit në këtë procedim penal, të ndërlydhura këto me momentin e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet kryerja e veprës penale.

**15.5.1.** Sikurse praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë<sup>29</sup> ka vendosur, cilësia e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, fillon: a) ose kur njoftuesi i saj mendon se e di, se cili mund të jetë autori i veprës penale dhe prokurori shënon paralelisht në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, krahas veprës edhe emrin e personit kur ai njihet, ose b) mbasi është bërë regjistrimi i veprës penale, që nga çasti i mëtejshëm kur nga hetimet rezulton një emër personi, të cilit i atribuohet vepra penale. Figura e krimit të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal dhe, aq më tepër, në rrethanat e rastit konkret, orientojnë drejt parashikimit sipas germës “a” më lartë, për sa kohë që targa e automjetit është identifikuar nga vetë viktimat, ishin kryer veprime nga ana e efektivëve të PSH, menjëherë pas ngjarjes, e në këto kushte, dhe regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale, sipas nenit 287 të K. Pr. Penale, duhej të bëhej nga subjekti i rivlerësimit krahas regjistrimit të procedimit penal.

**15.5.2.** Praktika gjyqësore e sipërcituar ka parashikuar se përcaktimi i termit: “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e përcaktuar nga neni 287 i K. Pr. Penale, si dhe pasur parasysh fazën procedurale në të cilën ai përdoret, do të thotë se ai nuk mund të barazohet me termin: “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime”, e as me termin person “i pandehur”. Atribuimi i faktit që përbën vepër penale ndaj një personi, nuk do të thotë se personi ka realisht lidhje me veprën penale.

**15.6.** Në përfundim lidhur me këtë procedim penal vlerësojmë se veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, në drejtim të respektimit të të drejtave të viktimave dhe regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, tregojnë për mangësi sipas përcaktimit të nenit 73, “Aftësia profesionale e prokurorit”, pika 2 e tij aspekti për të ndërmarrë logjikisht hetimin, dhe

<sup>26</sup> Referohuni f. 71-77 të versionit elektronik të aktit “Prapësime në lidhje me rezultatet e hetimit ...”.

<sup>27</sup> Referohuni pikës 30.22, f. 62 e vendimit.

<sup>28</sup> Referohuni pikës 30.25, f. 63 e vendimit.

<sup>29</sup> Referohuni vendimit nr. 2, datë 20.6.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**16. Ankesë e shtetasit** \*\*\* \*\*\*,<sup>30</sup> i cili ankohet se ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë Tiranë, por subjekti ka disponuar me vendim pushimi dhe nuk kishte kryer hetime të plota mbi rrethanat e kallëzuar. Ankuesi citon disa veprime hetimore, për të cilat pretendon se, nëse do të ishin kryer nga subjekti, hetimi do të kishte marrë rrjedhë tjetër.

**16.1.** Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit rezulton sa vijon:

**16.1.1.** Subjekti i rivlerësimit është prokurori i hetimit të procedimit penal me nr. \*\*\*, të vitit 2013, i regjistruar në datën \*\*.6.2013, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të Policisë të Komisarariatit të Policisë nr. 3, Tiranë (pa autor), me kallëzues shtetasin \*\*\* \*\*. Me vendimin e datës \*\*.5.2014, subjekti, z. Nushi, në cilësinë e prokurorit, pasi ka shqyrtuar aktet e administruara në fashikullin e hetimit, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2013.

**16.1.2.** Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm shtetasi \*\*\* \*\*, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal me nr. \*\*\*, të vitit 2013. Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme. Pretendimet e ankuesit për hetime të paplota janë gjetur të qenësishme dhe në këto kushte, bazuar në nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i pushimit që ka disponuar subjekti, është shfuqizuar me vendimin e prokurorit më të lartë, ku është konkluduar se vendimi i pushimit vjen në kundërshtim të plotë me provat e administruara në dosje dhe kërkesat e nenit 328 të K. Pr. Penale.

**16.1.3.** Në vendim janë përcaktuar të gjitha detyrat që duhet të realizoheshin nga subjekti i rivlerësimit, dhe me shkresën nr. \*\*\*/\*\*-extra, datë \*\*.1.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë vendimi i shfuqizimit, si dhe fashikulli i procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2015.

**16.2.** Komisioni, në aktin<sup>31</sup> “Rezultatet e hetimit administrativ ...”, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, të japë shpjegimet e nevojshme në lidhje me këtë situatë dhe veprimet e tij procedurale, mbi bazën e të cilave e ka marrë vendimin e tij për pushimin e procedimit.

**16.3.** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, është shprehur se: *[...] Ky vendim, në dijeninë time, ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Çuditërisht, në momentin kur Komisioni më ka përcjellë rezultatet e hetimit administrativ, jam venë në dijeni të faktit se kallëzuesi \*\*\*, kundër këtij vendimi, qenka ankuar jashtë afateve ligjore, konkretisht më datë \*\*.01.2015, jo në Gjykatë, por te Prokurori i Përgjithshëm i kohës dhe, ky i fundit, e paska shfuqizuar vendimin tim të pushimit dhe paska urdhëruar vazhdimin e hetimeve, por çuditërisht me sa kam marrë vesh, me tjetër prokuror, konkretisht prokurorin \*\*\*. \*\*\*. Pas interesimit tim për t’u njohur me aktet e kësaj dosjeje sot dhe për të marrë vesh se çfarë është shkruar në atë vendim shfuqizimi dhe çfarë ka ndodhur me pas me këtë dosje, jam informuar se as në Sekretarinë e Prokurorisë Tiranë dhe as në arshivë, fashikulli i këtij procedimi nuk gjendet dhe nuk dihet se çfarë ka bërë me të, prokurori që e ka pasë, deri më këtë datë që po shkruaj. Duke qenë se nuk e disponoj për studim, vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme të kohës, nuk mund të japë një vlerësim apo interpretim për të, aq më tepër që në kohën që flasim, ka qenë në fuqi neni 24 i K. Proc. Penale, që sanksiononte se urdhrat dhe udhëzimet me shkrim të Prokurorit më të lartë, në rastin konkret atij të Përgjithshëm, janë të detyrueshëm për zbatim nga prokurorët më të ulët dhe të paankimueshëm [...].*<sup>32</sup>

<sup>30</sup> Ankesa e z. \*\*\* është një nga katër ankesat e regjistruara në Regjistrat e Ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2022.

<sup>31</sup> Referohuni f. 34 së aktit “Rezultatet e hetimit...”.

<sup>32</sup> Referohuni f. 59-60 të versionit elektronik të aktit “Prapësime në lidhje me rezultatet e hetimit...”.

**16.4.** Komisioni arrin në përfundimin<sup>33</sup> se nuk konstatoi mangësi në veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit.

**16.5.** Komisioneri Publik vlerëson se hetimi i kryer në këtë procedim penal nga subjekti i rivlerësimit është i mangët dhe i paplotë në ato drejtime, sikurse është gjetur nga prokurori më i lartë, që ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit. Gjithashtu, padijenja e subjektit të rivlerësimit, si për vendimin e shfuqizimit nga prokurori më i lartë, i marrë në zbatim të nenit 24, pika 5, të Kodit të Procedurës Penale, përcjellë me shkresën e datës \*\*.1.2015, në Prokurorinë Tiranë, si dhe mungesa e dijenisë për vazhdimësinë më tutje të këtij procedimi penal, në të cilin ka qenë prokurori i çështjes (për sa kohë nuk ka referenca për kohën e marrjes nga prokurori tjetër), tregojnë për sjellje që bien nën veprimin e nenit 74, “Aftësitë organizative”, pika 5, e ligjit nr. 96/2016. Këto mangësi të evidentuara duhen marrë në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

### III.A / Etika

**17.** Pasuri në përdorim “Apartament me sip. 93 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë.

**17.1.** Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] Në përdorim pa akt, një banesë në pronësi të vjehrrit tim, \*\*\* \*\*\*, certifikatë pronësie nr. pasurie \*/\*\*\*+\*-\*, datë \*\*.12.2001, apartament me sip.93 m<sup>2</sup>, adresa Rruga “\*\*\*\* \*\*”, P.\*/\*\*, shk. \*, k. \*, ap.\*\*, Tiranë [...]. Vlera: 2.000.000 lekë. Burimi i krijimit: nuk deklarohet. Pjesa takuese: 0 %.<sup>34</sup>

**17.2.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të Pyetësorit nr.7, subjekti ka deklaruar se: [...] Ndërsa deri në vitin 2015, prindërit e bashkëshortes kanë jetuar në Elbasan, në një apartament me sip.67,2m<sup>2</sup>, i ndërtuar para viteve '90, në lagjen “\*\*\*\*”, pallati \*/\*, shk.\*, kt.\*, ap.\*, të përfituar me privatizim. Pas vitit 2015, për shkak të distancës së afërt dhe mundësisë për t'u kujdesuar për fëmijët e subjektit dhe për fëmijët e kumatës së tij, ata jetojnë edhe në apartamentin nr.\*\*\*, shtesë kati+ papafingo (dupleks) të ndërtuar mbi apartamentin ekzistues, ku banon subjekti i rivlerësimit [...].

**17.3.** Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim referuar si ASHK) ka konfirmuar se z. \*\*\*. \*\*\*. (vjehri i subjektit) është pajisur me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë \*\*.1.2015, shtesë 1 kat+1 kat papafingo mbi objektin ekzistues 5 kate, dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit: (i) Kërkesa për legalizimin e ndërtimit pa leje/shtesës informale në objekt me leje, datë \*\*.6.2013, me subjekt deklarues z. \*\*\*. \*\*\*, për legalizimin e shtesës së katit me sip. 81 m<sup>2</sup>; (ii) Procesverbali i verifikimit në terren nga inspektorët e ALUIZNI-t, datë \*\*.12.2014, nga ku ndërtimi pa leje/sipërfaqja shtesë që shfrytëzohet për banim është 153,3 m<sup>2</sup> (80,6 m<sup>2</sup> +72,7 m<sup>2</sup>); (iii) Akt-kualifikimi, datë \*\*.12.2014, për legalizimin e dy kateve shtesë me sip. 153,3 m<sup>2</sup>; (iv) Mandatpagesë nga \*\*\* Bank, datë \*\*.1.2015, në shumën 16.000 lekë, kryer nga subjekti i rivlerësimit me përshkrimin “ALUIZNI-Tirana 2, Pagesë tarifë shërbimi, \*\*\* \*\*”; (v) Leje legalizimi në emër të \*\*\* \*\*\*, datë \*\*/1/2015, për objektin shtesë kati 1 kat+papafingo mbi objektin ekzistues 5 kate, me sipërfaqe totale ndërtimi 153,3 m<sup>2</sup>.

**17.4.** Komisioni,<sup>35</sup> në përfundim, ka vlerësuar se: [...] subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 5, të nenit D, të aneksit

<sup>33</sup> Referohuni f. 44 të vendimit.

<sup>34</sup> Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se apartamenti me sip. 93 m<sup>2</sup> është blerë nga vjehri i tij, \*\*\*. \*\*\*, në datën \*\*.12.2001, në vlerën 2.000.000 lekë, me burim: (i) të ardhurat nga puna e tij në shtet deri në vitin 1991; (ii) të ardhurat e fitimet nga firma e tij e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k.; (iii) të ardhurat nga puna e vjehrrës si stomatologe në shtet, para dhe pas viteve '90; dhe më pas (iv) të ardhurat nga aktiviteti privat si stomatologe në Elbasan.

<sup>35</sup> Nisur nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe bazuar në kërkesën e datës \*\*.6.2013, për legalizimin e ndërtimit pa leje/shtesës informale, Komisioni ka konsideruar si periudhë investimi për apartamentin shtesë me sipërfaqe 153,3 m<sup>2</sup>, periudhën 2009-2013 dhe kosto mesatare të ndërtimit referuar EKB-së për sipërfaqen e shtesës prej 153,3 m<sup>2</sup> është përllogaritur 4.465.384 lekë, duke i kaluar barrën e provës.

të Kushtetutës. Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë kryer fshehje të pasurisë apartament dhe papafingo nr. \*\*, në pallatin nr. \*\*/\*, rruga “\*\*\*. \*\*\*.”. Kjo pasuri është në pronësi faktike dhe ligjore të vjehrrit dhe vjehrrës së subjektit të vlerësimit dhe është krijuar me burim nga të ardhura të ligjshme të tyre [...] <sup>36</sup>.

**17.5. Komisioneri Publik**, në gjendjen që janë aktet në dosjen e Komisionit, vlerëson se hetimi i Komisionit lidhur me pasurinë shtesë 1 kat + papafingo me sipërfaqe 153,3m<sup>2</sup> mbi pasurinë në përdorim të subjektit të rivlerësimit “Apartament me sip. 93 m<sup>2</sup>”, është i mangët në drejtim të dijenisë së subjektit për ndërtimin e paligjshëm dhe, rrjedhimisht, sjelljes së subjektit në raport me funksionin e magjistratit, për sa vijon:

**17.5.1.** Gjatë hetimit administrativ të Komisionit janë administruar: (i) praktika dokumentare e legalizimit të këtij ndërtimi, e finalizuar me Lejen e legalizimit me nr.\*\*\*, datë \*.1.2015, në emër të z. \*\*\* \*\*\*, ku subjekti i rivlerësimit rezulton se ka bërë pagesën e tarifës së shërbimit për legalizim më datë \*.1.2015, nga llogaria e tij pranë \*\*\* Bank; (ii) përgjigjet e subjektit të rivlerësimit për pyetjet e lidhura me kohën e ndërtimit, në të cilat referon si periudhë ndërtimi mesin e vitit 2014, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2 dhe vitet 2009-2010, në aktin “Prapësime të rezultateve të hetimit...”; (iii) kontratë qiraje e datës \*.7.2014, me afat 1-vjeçar dhe kontratë huapërdorje e datës \*.9.2015, me afat 1 vjeçar, të lidhura nga z. \*\*\*. \*\*\*, në cilësinë e qiradhënësit, si pronar i apartamentit me sip. 93 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*\*”, P.\*/\*, nr. \*\*, të nënshkruara nga personi i lidhur me subjektin, znj. \*\*\* \*\*\*, e cila vepron në emër të të atit, \*\*\*. \*\*\*, sipas prokurës së posaçme nr. \*\*\*/\*\*\*, datë \*.7.2014. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se këto kontrata kanë si objekt ndërtimin shtesë 1 kat + papafingo, të papajisur me certifikatë pronësie në atë kohë.

**17.5.2.** Referuar normativës ligjore në fushën e zhvillimit të territorit dhe kontrollit të punimeve të ndërtimit, të cilat për shkak të funksionit të prokurorit, prezumohet njohuria e subjektit të rivlerësimit për to, në rastin e ndërtimeve me leje parashikohet që në vende të dukshme vendoset tabela e identifikimit të punimeve të ndërtimit me të dhënat për objektin, destinacionin, *lejen e ndërtimit*, investitorin, subjektin projektues e mbikëqyrës dhe afatet e ndërtimit<sup>37</sup>, çka do të duhej të ishin evidentuar nga subjekti i rivlerësimit në rastin në fjalë.

**17.5.3.** Referuar dispozitave ligjore në fuqi në periudhën e ndërtimit të shtesës 1 kat + papafingo me sipërfaqe 153,3m<sup>2</sup>, ndërtimi i paligjshëm parashikohet si vepër penale e parashikuar nga neni 199/a<sup>38</sup> i Kodit Penal dhe subjekti i rivlerësimit, me njohuri të posaçme në këtë drejtim, duhet të ishte i vëmendshëm dhe nuk mund të pretendohet padijenja lidhur me çfarë ndodhte fizikisht mbi pasurinë e paluajtshme që kishte në përdorim, për sa kohë e gjithë veprimtaria ndërtimore lidhej dhe me kërkesën e tij për të përmirësuar kushtet e jetesës.

**17.5.4.** Sa referuar janë rrethana që tregojnë më së paku dijeninë e subjektit të rivlerësimit mbi moszbatimin e legjisllacionit në fuqi dhe se mbi pasurinë në përdorim të tij, “Apartament me sip. 93 m<sup>2</sup>”, për një periudhë disavjeçare, është ndërtuar një shtesë kati + papafingo me sipërfaqe 153,3m, <sup>2</sup> jo në zbatim të normativës ligjore.

**17.5.5.** Sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo mënyrë sjellje e zgjedhur nga subjekti të rivlerësimit duket se tregon një qasje të caktuar në raport me respektimin e ligjit, zbatimin e të cilit është detyrë themelore e një magjistrati, nëpërmjet ushtrimit të funksionit të tij, por jo vetëm. Sjellja e jashtme, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti

<sup>36</sup> Referohuni f. 20 të vendimit.

<sup>37</sup> Udhëzim nr. 2, datë 13.5.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu II, pika 1.3.

<sup>38</sup> Referohuni ligjit nr.10 023, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7985, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, botuar në Fletoren zyrtare nr.190, datë 31.12.2008.

dhe autoriteti i sistemit të drejtësisë, është objekt rregullimi i normave të etikës së prokurorit<sup>39</sup> dhe pjesë e standardeve<sup>40</sup> që udhëzojnë shembuj më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Në këtë kuptim, kjo çështje do të duhet të merret në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

### **III.B Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

**18.** *Pasuria e paluajtshme “Apartament me sipërfaqe 153 m<sup>2</sup>”, me adresë rruga “\*\*\* \*\*”, Tiranë, si dhe adresat e banimit të deklaruar ndër vite.*

**18.1.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. *Dritan Nushi*, ushtron funksionin e prokurorit prej vitit 2002, duke deklaruar interesat privatë për herë të parë në vitin 2003 dhe, më pas, në mënyrë periodike për çdo vit, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

**18.2.** Në DV-2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi: [...] *B/pronar me 1/3 i një apartamenti sip.153 m<sup>2</sup> i pahipotekuar në Tiranë, në adresë Nj. \*\*, Rr. “\*\*\*. \*\*\*” P.\*\*\*/\*, ap. \*. (Vendimin nr.\*\*\*, regjistri \*\*\*, datë \*\*.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Fier)* [...]. Nuk rezulton që kjo pasuri të jetë deklaruar në ndonjë deklaratë tjetër periodike vjetore.

**18.3.** Komisioni në aktin “*Rezultatet e hetimit administrativ ...*” ka pasqyruar hetimin e kryer në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme dhe aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, sipas të cilave rezulton sa vijon:

**18.3.1.** Origjina e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 153 m<sup>2</sup>”, rrjedh nga “Akt-Marrëveshja” datë \*\*.10.2002, e lidhur midis sipërmarrësit shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësit \*\*\* \*\*\*, për të ndërtuar një apartament me sipërfaqe 152 m<sup>2</sup> kundrejt vlerës 58.000 USD. Në akt-marrëveshje, ka një shënim në dorëshkrim, si vijon: [...] *Me lidhjen e kontratës derdhen 50.000 USD. Pjesa tjetër, 8.000 USD, derdhet me lidhjen e kontratës përfundimtare të shitblerjes* [...].

**18.3.2.** Referuar korrespondencës me operatorin e furnizimit me energji elektrike dhe atë të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe vetë deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, apartamenti është bërë i banueshëm në tremujorin e parë të vitit 2004. Kontrata e shitjes për këtë pasuri është e datës \*\*.6.2012, lidhur midis shitësit shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerëses \*\*\* \*\*\* (e ëma e subjektit), me çmim të shitjes 58.000 USD, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**18.3.3.** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, shprehet se: [...] *babai ka paguar dy këstet e para vetë dhe se, pas vdekjes së babait, nëna është pronare e vetme e apartamentit, pasi ka paguar këstin e tretë, ka lidhur kontratën e shitblerjes datë \*\*.6.2012 dhe e ka regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme* [...]. Në vijim, subjekti deklaroi se, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë, datë \*\*.6.2010, ka deklaruar në DV-2010 se është bashkëpronar me 1/3 e këtij apartamenti, pa u konsultuar me nënën dhe duke menduar se e gjithë vlera ishte likuiduar nga babai i tij. Më vonë, pasi mori vesh statusin e kësaj prone, nuk e ka deklaruar më bashkëpronësinë, duke e konsideruar këtë një gabim të tij. Në vijim, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka asnjë tagër mbi këtë pronë, pasi është ndarë nga trangu familjar qysh në vitin 2005, kur edhe prindërit e tij nuk kishin tagër pronësie mbi këtë apartament, i cili ishte në pronësi të shoqërisë ndërtuese dhe, vetëm në vitin 2012, nëna e tij u bë pronare e vetme.

<sup>39</sup> Referohuni “Rregulla mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr.141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, neni 3, germa “ë”, dhe neni 6.

<sup>40</sup> Rekomandim Rec (2000) 19, “Mbi Rolin e Prokurorisë në sistemin e drejtësisë penale”, adaptuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 6 qershor 2000, f. 4, pika 1 dhe pjesa e komentarit të rekomandimit f. 14.

**18.4.** Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...] referuar fakteve që kjo pasuri është blerë nga prindërit e subjektit të rivlerësimit me të ardhurat nga puna e tyre dhe nuk u vërtetua që subjekti të ketë kontribuar financiarisht në krijimin e saj; pothuajse i gjithë çmimi i blerjes është paguar që në vitin e parë të subjektit në detyrë nga familja e origjinës së subjektit; kontrata e shitblerjes së apartamentit është lidhur nga nëna e tij, çka e bën atë pronarë të vetme mbi këtë pasuri; subjekti ka banuar në apartament për shkak të marrëdhënies familjare vetëm në vitet 2004 – 2005, për një kohë të shkurtër, më pak se dy vjet, si pjesë e familjes së tij të origjinës dhe përpara se të lidhte martesë; subjekti që nga viti 2006 e në vazhdim ka jetuar me bashkëshorten dhe fëmijët e tij në apartamentin e blerë nga vjehri i tij, \*\*\*, \*\*\*,; në këtë apartament kanë banuar dhe vazhdojnë të banojnë pa ndërprerje nëna dhe motra e subjektit – në përfundim të hetimit, Komisioni nuk gjeti asnjë element që e lidh subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri, nuk konstatoi problematika të karakterit ligjor për këtë pasuri dhe nuk ngriti dyshime se ajo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, prandaj vlerësoi të mos hetojë më tej për mundësinë financiare të krijimit të kësaj pasurie nga familja e origjinës së subjektit të rivlerësimit [...].<sup>41</sup>

**18.5.** Komisioneri Publik, në gjendjen që janë aktet, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni për sa vijon:

**18.5.1.** Sikundër ka rezultuar, në DV-2010, subjekti ka deklaruar pronësi me 1/3 pjesë takuese të tij në apartamentin me sip. 153 m<sup>2</sup>, i pahipotekuar në Tiranë, në adresën rruga “\*\*\* \*\*”. Nuk rezulton që ta ketë deklaruar këtë pasuri në deklaratën e parë DV-2003, si dhe as në DV-2004 dhe DV-2005, moment kur shkëputet nga trangu familjar.

**18.5.2.** Sipas akt-marrëveshjes së datës \*.10.2002, akt origjinar i kësaj pasurie, ka rezultuar se shuma 50.000 USD është paguar me lidhjen e saj, tetor 2002, kohë kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në marrëdhënie pune<sup>42</sup>

**18.5.3.** Përveç sa më sipër, nga aktet në dosje kanë rezultuar deklaramë kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi adresat e banimit të tij ndër vite, duke filluar nga deklarata e parë e vitit 2003 e në vijim<sup>43</sup>, deklaramë që duket se gjejnë reflektim edhe nga akte të tjera<sup>44</sup> të administruara në dosje të Komisionit gjatë hetimit, në emër të familjarëve të tij.

**18.5.4.** Sa më sipër trajtuar, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të vazhdueshme, nuk ka qenë koherent në deklaramët e tij lidhur me vendbanimet. Për më tepër deklaramët kontradiktore të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, krahasuar me deklaramët periodike të tij dhe dokumentacionin e përfituar nga hetimi administrativ mbi vendbanimin e tij dhe

<sup>41</sup> Referohuni pikës 16.12 të vendimit.

<sup>42</sup> Në pozicionin oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë Tiranë, për periudhën 1998 - 2002, dhe atë të prokurorit nga muaji shkurt 2002.

<sup>43</sup> Në DV-2003, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” P. \*\*/\*; Në DV-2004, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\* h 1 apt. 10 (qira); Në DV-2005, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\* 3, 22; Në DV-2006 deri 2008, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\*, hyrja 3, apt. 22; Në DV-2009, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\*, hyrja 3; Në DV-2010 dhe 2011, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\*, hyrja 3, apt. 22; Në DV-2012 si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\*, hyrja 3; Në DV-2013, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\*, hyrja 3, apt. 11; Në DV-2014 deri 2016, si adresë banimi deklaron: Rruga “\*\*\* \*\*” \*\*/\*, hyrja 3.

<sup>44</sup> Në aktin e regjistrimit të makinave, bashkëlidhur kontratës së dhurimit të automjetit nr. \*\*\*/\*\*, datë \*.12.2001, për subjektin e rivlerësimit Dritan Nushi referohet si adresë banimi: njësia \*, Rr. “\*\*\* \*\*”, p.\*\* \*\*/\*/. Në aktet shoqëruese të dosjes rezultojnë dy vërtetime të lëshuara nga Njësia Bashkiake nr. \*, në emër të subjektit të rivlerësimit (datë \*.12.2001) dhe të atit, z. \*\*\* \*\* (datë \*.11.2001), ku vërtetohet se janë banorë të Njesisë nr. \*, në adresën rr. “\*\*\* \*\*”, pall. \*(shk. \*, subjekti dhe shk. \*, babai i subjektit), ap. \*. Në kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*/\*\*, të datës \*.6.2003, subjekti ka deklaruar si adresë banimi apartamentin të ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”. Në kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. \*\*\*/\*\*, datë \*.12.2004 dhe në aktin “Regjistrimi i Makinave”, datë \*.3.2005, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: \*\*\*, \*\*, \*, Rr. “\*\*\* \*\*”, pall. \*\*/\*, Tiranë. Në kontratën e shitblerjes së automjetit nr. \*\*\*/\*\*, datë \*.7.2006, babai i subjektit deklaron si adresë banimi rrugën “\*\*\* \*\*”. Nëna e subjektit, në hapjen e kontratave për shërbime bankare me \*\*\* në vitin 2017, deklaron si adresë banimi rrugën “\*\*\* \*\*”.



familjarëve të tij, krijojnë paqartësi se ku ka jetuar subjekti i rivlerësimit ndër vite, duke e bërë të pamundur verifikimin e situatës reale.

**18.6.** Në përfundim, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramë të pasakta dhe kontradiktore, duke e vendosur organin e rivlerësimit në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar këto pasuri dhe burimet e ligjshme të krijimit të tyre, çka vlerësohet se duhet analizuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shkaqet e tjera në ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

#### **19. Automjetit tip “Daimer Chrysler”, me targë \*\*\* NC, në përdorim**

**19.1.** Në përgjigje të Pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka përdorur automjetin e motrës së tij për disa udhëtime jashtë vendit, duke paraqitur prokurën e posaçme nr. \*\*\*/\*\*\*/\*, datë \*\*.11.2016, me anë të së cilës shtetasja \*\*\*. \*\*\*, motra e subjektit, e ka autorizuar subjektin e rivlerësimit ta përdorë këtë automjet pa asnjë kufizim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një afat të pakufizuar.

**19.2.** Nuk rezulton që përdorimin e këtij automjetit ta ketë deklaruar në D-Vetting, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

**19.3.** *Komisioneri Publik*, në vlerësim të akteve si më sipër dhe në referencë të kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe aneksit D të Kushtetutës, mbi detyrimin që kanë subjektet e rivlerësimit për deklarimin e pasurive në përdorim në momentin e plotësimit të D-Vetting, për sa kohë kontrata e huapërdorjes është pa afat, vlerëson se mosdeklarimi i përdorimit të këtij automjeti në D-Vetting, e bën deklarimin e subjektit të pasaktë, në kuptim të pikës 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

**20.** Në përfundim, *Komisioneri Publik* vlerëson se të gjitha konkluzionet e mësipërme, në një vlerësim tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Nushi, gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**21.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

**22.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**23.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

**24.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

**25.** Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 735, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Nushi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**